



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:148340

Datë: 01.03.2024

Numri i dokumentit: 05399029

KPPP.nr. 1024/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A., me seli në Prishtinë, kundër debitorit N.T.P “Ballabani Komerc” me numër të biznesit 80047134 dhe seli në Prishtinë, rr. “Agim Ramadani”, lokali nr. 22/96, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.P., avokat me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 93/23, i lejuar me datë 31.05.2023, nga Përmbartuesi Privat Isak Islami me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 01.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit N.T.P “Ballabani Komerc” me numër të biznesit 80047134 dhe seli në Prishtinë, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 93/23, i lejuar me datë 31.05.2023, nga Përmbartuesi Privat Isak Islami, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumenteve, përkatësisht Faturës nr. 2023/01629, e datës 01.05.2023, ka lejuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 93/23, të datës 31.05.2023, me të cilin është urdhëruar debitori që, brenda afati prej 7 ditësh nga data e pranimit të urdhrin, kreditorit t’ia paguaj shumën prej EUR 2,065.25 për periudhën kohore 01.03.2022 deri më 31.05.2023, me kamatë prej 8%, duke filluar nga data e dorëzimit të propozimit për përmbartim e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin mbi lejimin e përmbarrimit, me arsyetim se dokumenti në bazë të cilit është marrë urdhri përmbarrues nuk përbën titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë, duke qenë e pa qartë se mbi cilin titull ekzekutiv mbështet propozimi për përmbarrim, në faturën nr. 2023/01629 të datës 04.05.2023, apo në kartelën financiare të datës 31.05.2023. Më tej, ka theksuar se fatura nr. 2023/01629 e datës 01.05.2023 nuk përbën titull përmbarrimor për shumën e treguar në propozimin për përmbarrim, pasi që vlera totale e saj është EUR 178.53, ku nuk përputhet me shumën totale të treguar në propozimin përmbarrim prej EUR 2,065.25. Ndërsa, ka shtuar se përmbarrimi i borxhit që rrjedh nga kontrata e qirasë së lokalit nuk mund të kërkohet bazuar në kartelën financiare të datës 31.05.2023, të nxjerrë për qiradhënien e lokalit nr. 22/96 që gjendet në rrugën “Agim Ramadani”, sepse e njëjta nuk përbën dokument të përshtatshëm për përmbarrim, për shkak se nuk hyn në asnjërën prej kategorive të parapara shprehimisht me nenin 29.1 të LPP-së, e poashtu e njëjta nuk mund të cilësohet si ekstrakt i verifikuar nga librat afarist sepse nuk i referohet pagesës së shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe/apo bartjen e mbeturinave. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta aprovoj si të bazuar, ndërsa urdhri mbi lejimin e përmbarrimit të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit si të pabazuara dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore për arsye se prapësimi i debitorit është i pa argumentuar, duke mos ofruar prova për të argumentuar se ekziston ndonjëra nga shkaqet e parapara në nenin 71 të LPP-së, prandaj pretendimet e debitorit nuk e lirojnë të njëjtin nga detyrimi që rrjedhë nga kontrata e qirasë për lokalin afarist i cili gjendet në Prishtinë, rruga “Agim Ramadani”, nr. 22/96. Tutje, ka kundërshtuar pretendimet e debitorit lidhur me mungesën e tipareve të përmbarrueshmërisë së faturës nr. 2023/01629 të datës 01.05.2023 sepse fatura është lëshuar nga kreditori, është pranuar dhe nuk është kontestuar nga debitori, e poashtu në faturë është përshkruar edhe shuma e borxhit për muajin maj 2023 si dhe shuma e përgjithshme e borxhit prej EUR 10,3282.30, si dhe shuma e borxhit prej EUR 2,065.25 përputhet edhe me ekstraktin e verifikuar nga librat e kontabilitetit (kartelën financiare) e cila është e bashkangjitur në propozimin për përmbarrim, ku është e përshkruar edhe periudha e borxhit të kërkuar në propozim prej datës 01.03.2022 deri më 31.05.2023. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbarrimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke

iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.3 e po të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 është përcaktuar se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - Fatura nr. 2023/01629, e datës 01.05.2023, mbi bazën e së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, ngase në faturë nuk është përcaktuar qartë detyrimi i debitorit. Përkatësisht, fatura rezulton të jetë lëshuar në emër të kërkesave nga qiraja mujore për muajin Maj 2023, në vlerë prej EUR 178.53, ndërsa në faturë është paraqitur borxhit total i akumuluar në lartësi prej EUR 10,382.30, mirëpo nuk është pasqyruar periudha kohore për të cilën është akumuluar ky borxh. Andaj, duke qenë se objekt i faturës janë kërkesat nga qiraja të cilat janë natyrës periodike, ndërsa në të njëjtën faturë është pasqyruar borxhi i akumuluar, e njëjta faturë si e tillë nuk është e përshtatshme për përmbartim.

Në anën tjetër, gjykata ka vlerësuar edhe ekstraktin nga librat e kontabilitetit – kartelën financiare të datës 31.05.2023 të cilën kreditori ia ka bashkëngjitur propozimit për përmbartim, mirëpo gjeti se i njëjti nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, pasi që objekt i ekstraktit janë kërkesat në emër të qerasë, ndërsa në me nenin 29, paragrafi 1, pika 1.2 të LPP-së, janë përcaktuar në mënyrë taksative se për cilat shërbime ekstraktet e verifikuara nga librat afariste përbëjnë dokument të besueshëm.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit Përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit duhet të anulohet.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 71, pika 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1024/23, datë 01.03.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimt të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.